



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7485 / Prot.
1

Tiranë, më 01.12. 2023

UDHËZIM

Nr. 25, datë 01.12. 2023

PËR

PILOTIMIN E SKEMËS SË MËSUESIT NË DISPOZICION
DHE DETYRAVE TË TIJ NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 6 të nenit 57 dhe të neneve 26 dhe 60 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

1. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) organizon punën me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe përcaktimin e detyrave të tij, për vitin shkollor 2023-2024.
2. ZVA emëron si mësues në dispozicion mësuesit që në fillim të vitit shkollor ngelen pa ngarkesë mësimore, në rast se nuk plotësohen vendet vakante atëherë përzgjidhen aplikantët nga portali "Mësues për Shqipërinë", duke respektuar udhëzimin në fuqi.
3. ZVAP-ja emëron mësuesit në dispozicion me kontratë pune me afat të caktuar deri në përfundim të vitit shkollor, sipas numrit dhe profileve të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
4. Numri i mësuesve në dispozicion në fazën e pilotimit të skemës dhe institucionet arsimore parauniversitare ku do të punësohen, përcaktohet në aneksin 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
5. Detyrat e mësuesit të dispozicionit përfshijnë dhe detyrat në lidhje me përfundimin për lëndët që do të mbulojë sipas nevojave të kërkuara nga institucioni shkollor kur nuk paraqitet nevoja e zëvendësimit (dispozicionit).

KREU II

Detyrat e mësuesit në dispozicion

1. Mësuesi në dispozicion është mësuesi që zëvendëson lëndët mësimore të përcaktuara në aneksin 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, në rastet kur:
 - a) mungojnë në punë mësues për arsye shëndetësore, të cilët trajtohen me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme që paguhen nga punëdhënësi;
 - b) mungojnë në punë mësues me leje administrative, me ose pa të drejtë page, sipas përcaktimeve të nenit 96 të Kodit të Punës dhe të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, që miraton rregullat për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Mësuesi në dispozicion realizon orë përforcimi me nxënësit me arritje të ulëta për lëndët ku zhvillohet përforcimi. Në kontratën e punës përcaktohet institucioni arsimor publik parauniversitar, ku mësuesi në dispozicion do të zhvillojë orët e përforcimit.
3. Mësuesi në dispozicion zbaton orarin mësimor, orarin e përforcimit dhe planin mësimor të miratuar nga drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar, ku do të realizojë zëvendësimin/përforcimin.

KREU III

Ngarkesa mësimore javore dhe realizimi i saj

1. Ngarkesa mësimore javore e mësuesit në dispozicion është sa ngarkesa javore e mësuesit të arsimit bazë të profilit/lëndës përkatëse.
2. Drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar, sapo merr informacion për mungesën në punë të mësuesit, informon ZVAP-në, e cila njofton menjëherë mësuesin në dispozicion për institucionin ku do të paraqitet në punë për zëvendësim. Njoftimi i mësuesit, në rastet kur është e mundur, të bëhet një ditë përpara zëvendësimit.
3. Mësuesi në dispozicion, pas njoftimit të marrë nga ZVAP-ja, komunikon me drejtorinë e institucionit arsimor publik parauniversitar ku do të paraqitet, për t'u informuar për orarin mësimor dhe temat mësimore, si dhe njofton drejtorinë e institucionit arsimor publik parauniversitar, ku zhvillon orët e përforcimit.
4. Gjatë kohës që mësuesi nuk ka orë në skemën e zëvendësimit, kryen detyra të ngarkuara nga drejtoria e shkollës, që lidhen me përforcimin.
5. Përforcimi në arsimin fillor, për lëndët e përcaktuara në aneksin 3, realizohet me 3 orë në javë gjithsej.
6. Përforcimi në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë për lëndët gjuhë shqipe-letërsi dhe matematikë realizohet me nga 2 orë në javë, ndërsa për lëndët e tjera realizohet me nga 1 orë në javë për secilën prej tyre.
7. Grupet për orët e përforcimit për klasë/klasa paralele për secilën lëndë krijohen sipas rregullave ku një grup mund të ketë nga 10 deri në 25 nxënës.
8. Drejtoria e institucionit arsimor publik parauniversitar cakton grupet e nxënësve dhe harton orarin e orëve të përforcimit që do të zhvillohen në atë institucion për çdo javë mësimore.

9. Në përfundim të çdo muaji, drejtorja e institucionit/institucioneve arsimor/e publik/e parauniversitar/e, ku mësuesi në dispozicion ka kryer orët mësimore të zëvendësimit/orët e përforcimit, dërgon zyrtarisht në ZVAP formularin e mësuesit në dispozicion sipas aneksit 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Një kopje e formularit i dorëzohet edhe mësuesit në dispozicion.

KREU IV Dispozita të fundit

1. Pika 9 e kreut 8/1 të udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

MINISTRI

OGERTA MANASTIRLIU



Aneksi 1. Profili i mësuesit që do të emërojnë ZVAP, sipas numrit të miratuar.

Numri i mësuesve të miratuar	Profilët për çdo mësues
1	Arsim fillor
2	Arsim fillor; Gjuhë Shqipe-Letërsi
3	Arsim fillor; Gjuhë Shqipe-Letërsi; Matematikë-Fizikë
4	Arsim fillor; Gjuhë Shqipe-Letërsi; Matematikë-Fizikë; Gjuhë e huaj;
5	Arsim fillor; Gjuhë Shqipe-Letërsi; Matematikë-Fizikë; Gjuhë e huaj; Biologji-Kimi
6	Arsim fillor; Gjuhë Shqipe-Letërsi; Matematikë-Fizikë; Gjuhë e huaj; Biologji-Kimi; Histori-Gjeografi
Më shumë se 6 mësues	Emërohen sipas rregullit të përcaktuar në këtë aneks.

Aneksi 2

a) Numri i mësuesve në dispozicion sipas ZVAP ku do të emërohen

Nr.	DRAP	ZVAP	Numri i mësuesve në dispozicion
1.	Durrës	Dibër	2
2.	Durrës	Durrës	6
3.	Durrës	Kamzë	6
4.	Durrës	Krujë	2
5.	Durrës	Tiranë	20
6.	Durrës	Vorë	2
7.	Fier	Fier	6
8.	Fier	Gjirokastër-Libohovë	2
9.	Fier	Lushnjë	2
10.	Fier	Sarandë-Delvinë-Konispol	2
11.	Fier	Vlorë-Himarë	6
12.	Korçë	Berat	2
13.	Korçë	Elbasan	6
14.	Korçë	Korçë-Pustec	2
15.	Korçë	Librazhd	2
16.	Korçë	Përrenjas	2
17.	Lezhë	Has	2
18.	Lezhë	Kukës	2
19.	Lezhë	Lezhë	2
20.	Lezhë	Shkodër	6
		Gjithsej mësues	82

b) Institucionet arsimore ku do të pilotohet përforcimi

Nr.	DRAP	ZVAP	Institucioni arsimor	Lloji i IA-së	Numri i nxënësve
1.	Durrës	Kruje	"Adem Gjeli"	Arsim bazë	1626
2.	Durrës	Tiranë	"Kongresi i Manastirit"	Arsim bazë	1491
3.	Durrës	Tiranë	"Edith Durham"	Arsim bazë	1418
4.	Durrës	Kamëz	"100 Vjetori"	Arsim bazë	1314
5.	Durrës	Tiranë	"Vasil Shanto"	Arsim bazë	1232
6.	Durrës	Kamëz	"Azem Hajdari"	Arsim bazë	1230
7.	Durrës	Tiranë	"Fan S. Noli"	Arsim bazë	1105
8.	Durrës	Tiranë	"Emin Duraku"	Arsim bazë	1077
9.	Fier	Sarandë-Konispol-Delvinë	"Adem Sheme"	Arsim bazë	1002
10.	Fier	Fier	"Andon Xoxa"	Arsim bazë	974
11.	Durrës	Durrës	"Qemal Mici"	Arsim bazë	972
12.	Korçë	Elbasan	"Luigj Gurakuqi"	Arsim bazë	949
13.	Lezhë	Shkodër	"Ismail Qemali"	Arsim bazë	895
14.	Durrës	Durrës	"Marie Kaçulini"	Arsim bazë	882
15.	Durrës	Dibër	"Selim Alliu"	Arsim bazë	839
16.	Fier	Gjirokastër-Libohovë	"Koto Hoxhi"	Arsim bazë	825
17.	Fier	Fier	"Naim Frashëri"	Arsim bazë	815
18.	Lezhë	Kukës	"Avni Rustemi"	Arsim bazë	803
19.	Fier	Vlorë-Himarë	"Ismail Qemali"	Arsim bazë	799
20.	Durrës	Vorë	"Vajdin Lamaj"	Arsim bazë	775
21.	Lezhë	Has	"Sejdi Dida"	Arsim bazë	763
22.	Lezhë	Shkodër	"Ndre Mjeda"	Arsim bazë	744
23.	Fier	Vlorë-Himarë	"Jani Minga"	Arsim bazë	702
24.	Fier	Lushnje	"Skënder Libohova"	Arsim bazë	695
25.	Korçë	Korçë-Pustec	"Sevasti Qirjazi"	Arsim bazë	693
26.	Korçë	Elbasan	"Jorgji Dilo"	Arsim bazë	685
27.	Lezhë	Lezhë	"Besëlidhja"	Arsim bazë	664
28.	Korçë	Përrenjas	"Qybra Sokoli"	Arsim bazë	637
29.	Korçë	Librazhd	"Genc Leka"	Arsim bazë	573
30.	Korçë	Berat	"22 Tetori"	Arsim bazë	540

Aneksi 3: Lëndët mësimore që zëvendëson dhe lëndët ku do të zhvillojë përforcim

Nr.	Profili i mësuesit	Lëndët mësimore që zëvendësojnë	Lëndët ku do të realizohet përforcimi
1.	Arsim fillor	Arsimi fillor	Gjuhë shqipe, Matematikë të klasave I-V
2.	Gjuhë shqipe - Letërsi	Gjuhë shqipe Letërsi Teatër Art pamor Muzikë	Gjuhë shqipe, Letërsi
3.	Gjuhë e huaj anglisht	Gjuhë e huaj anglisht Gjuhë të dytë kur e ka të mbrojtur	Gjuhë të huaj anglisht
4.	Matematikë-Fizikë	Matematikë Fizikë TIK Aftësim teknologjik	Matematikë, Fizikë
5.	Biologji-kimi	Biologji Kimi	Biologji, Kimi
6.	Histori-Gjeografi	Histori, Gjeografi, Qytetari, Sociologji, Filozofi, Ekonomi, Psikologji	Histori, Gjeografi, Ekonomi

Aneksi 4: Formulari i mësuesit në dispozicion

Institucioni arsimor publik parauniversitar/Shkolla _____

Emri e mbiemri i mësuesit në dispozicion _____

Periudha e angazhimit: nga _____ deri më _____

Nr.	Profili i mësuesit	Lëndët mësimore që ka realizuar dhe numri i orëve për çdo lëndë	Numri i orëve të përforcimit dhe i orëve të tjera që ka realizuar mësuesi	Numri i orëve të zhvilluara gjithsej
1.				